REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
1072, 1080, 1083, 1089,
Nr/Br. 1097 / 20
Datës/Datum 31.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**17.12.2020**	**31.12.2020**	**Nr.1072-1080-1083-1089-1097/20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Nga data 09-14 dhjetor 2020, Operatori ekonomik **"EL-Power & AL-Focus"** ka parashtruar ankesën me për **Lot 4** ndërsa Operatorët ekonomik **"Electra", "Doko"** dhe **"G3 Inxhinering"** kane parashtruar ankese për **Lot 3** si dhe **OE "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport"** ka parashtruar ankese për **Lot 1**, kundër vendimit për **dhënie** të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP"** me nr. prok. KOSTT-20-4505-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Operator i Sistemi, Transmisionit dhe Tregu- KOSTT SH.A..**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: **punë**, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës:

- **LOT 1- Ndërtimi i NS 110 10(20) kV Ferizaj 3,** Vlera e parashikuar **4,956,000.00 €;**
- **LOT 3- Ndërtimi i Nënstacionet te Ri - AIS 220 35 10(20)kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV**, Vlera e parashikuar **4,550,000.00 €.**
- **LOT 4- Furnizimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 110 35 10(20) kV Fushë Kosova dhe NS 220 35 10(20)kV Malisheva,** Vlera e parashikuar-**1,700,000.00 €**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "EL-Power & AL-Focus" LOT 4.

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- OE "EL-Power & AL-Focus" ne ankesën e tije deklarohet se janë shkelur dispozitat e LPP dhe dispozitat e RRUOPP, **pa i theksuar se cilat nene dhe dispozita janë shkelur**.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta

Grupi ynë i Operatoreve Ekonomik EL-POWER, AL FOCUS7 sh.p.k jemi njoftuar nga AK se oferta (tenderuesi) i pasuksesshëm për tenderin ne fjale, pa te drejte, ne mënyrë jo objektive dhe jo ligjore për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo te drejte te gjendjes faktike si dhe shkeljes se dispozitave ligjore nga ana e AK Oper.Sistemi,Trans, Dime Trgu KOST SHA, kështu qe duke u bazuar ne këtë, konsiderojmë se vendimi për eliminimin tone është plotësisht i padrejte, jo objektiv dhe i shoqëruar me shkelje, ligjore, ku janë shkelur ne tërësi dispozitat e Ligjit te Prokurimit (LPP-s)Nr.04/L-042 si dhe dispozitat e Rregullave dhe UOPP-se cilat i precizojmë si me poshtë.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "Electra" LOT 3.

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 28 i LPP – Variantet e Specifikimeve teknike
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies se kontratës

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta

Autoriteti kontraktues KOSTT ka bere keto shkelje si ne vijim:

1. Ne dosjen e tenderit Seksioni II. Fleta e te dhënave te Tenderit (FDT) PIKA 4.1 Variantet nuk kane qene te autorizuara.

Operatori Ekonomik Enbi Power SH.P.K i shpallur fitues nga KOST me datën date 24.11.2020 ne dosjen e tenderit për te cilën kemi aplikuar te kemi qasje dhe gjate kontrollës kemi hasur qe Operatori ekomomik Enbi Power ka dorëzuar dy variante te njëjta te zgjidhjes teknike nga dy prodhues te ndryshëm per Mbrojtje Rele dhe SCADA nga Prodhuesit SIEMENS dhe GENERAL ELECTRIC. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues KOSTT dhe Operatori Ekonomik Enbi Power kane bere shkelje te ligjit te prokurimit përkatësisht nenit 29 (Variantet e specifikimeve Teknike) te këtij ligji.

Pjesa riga Fleta e te dhënave te Tenderit F02 Formulari Standard për rishqyrtimet vendimit ne AK. Pjesa e shkëputur nga ligji i prokurimit Nr. 04/L-042 te Republikës se Kosovës, Neni 29 (variantet e specifikimeve teknike.

Ne baze te kësaj pike ne konstatojmë qe Autoriteti Kontraktues KOSIT si dhe komisioni për vlerësim është dashtë qe Operatorin Ekonomik Enbi Power ta kualifikojnë si te pa përgjegjshëm ngase shihet qe ka here shkelje te ligjit te prokurimit. Edhe ne raportin e vlerësimit te komisionit është evidentuar si gjetje, mirëpo prape se prape nuk janë marr parasysh dhe kane vazhduar me shpallje fitues te këtij OE.

2. Autoriteti Kontraktues KOSTT ne përgjigjet klasifikuese te dërguara me date 24.09.2020 nga ora 14:12 deri ne orën 14:52 dokumenti 4. Add information No 3- part two-20200924 .

Operatori ekonomik Enbi Power ne dosjen e dorëzuar ne KOSTT dhe pyetjet qe janë bere nga komisioni për vlerësim Operatori Ekonomik Enbi Power është deklaruar se pranon qe mbrojtjet te jene nga prodhuesi Siemens dhe ne gjate kontrolles kemi pare qe Operatori Ekonomik Enbi Power ka deklaruar se për Mbrojtjet Rete "backup" te prodhuesi ABS ose Schneider Electric dhe për këto mbrojtje gjate kontrollës qe i kemi bere kemi ardhur ne përfundim qe mungon deklarata e nënshkruar nga Operatori Ekonomik si dhe Referencë Lista duke specifikuar te gjitha pajisjet ku janë liferuar për Mbrojtje Rele për Prodhuesit ABB.

F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK ose Schneider Electric.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 2/aqe 9 Thuhet qe Main 2 është SchniderlABB.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 2.1. përgjigjet kalrifikuese ng« KOS1T per Main 2 relay protection thuhet qe operatori duhet te këtë te liferuara ne tregun e BE 25 furnizime për secilin prodhues.
Vlen te ceket se edhe ne kete pike ka shkelje nga Operatori Ekonomik pasi qe ka ofruar dy variante leu sipas nenit 29 te ligjit te prokurimit dhe kërkesës ne FTD është e ndaluar te ofrohen variante si dhe mungon Lista e referencave ku dëshmohet se janë te furnizuara ne tregun e BE 25 cope per secilin prodhues.

Autoriteti Kontraktues KOSTI ka bere shkelje pasi qe ne baze te kësaj gjetje, qe ka qene e kërkuar ne përgjigjet klarifikuese e kane kualifikuar si te përgjegjshëm ku ne fakt do te duhet te ishte e kundërta dhe te shpallej i pa përgjegjshëm.

3. Autoriteti Kontraktues KOSTI ne dosjen e tenderit Seksioni II. Fleta e te dhënave te Tenderit(FTD). Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Pika 9.1 & 9.2, Kërkesa për LOT 3 thotë qe te dorëzohet Autorizimi i Prodhuesit, OE duhet ne ofertën e tij te prezanton kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi për Ndërprerës, Mbrojtje Rete rille Ndarës ."
Operatori ekonomik Enbi Power ne dosjen e dorëzuar ne KOS'n' dhe pyetjet qe janë bere nga komisioni për vlerësim Operatori Ekonomik Enbi Power eshte deklaruar se pranon qe mbrojtjet retë te jene nga prodhuesi Siemens dhe ne gjate kontrolles kemi pare qe Operatori Ekonomik Enbi Power ka deklaruar se per Mbrojtjet Rele "backup ose" rezerve" do te jene te prodhuesit ASS ose Schneider Electric dhe për këto Mbrojtje Rele Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar autorizim nga prodhuesi ABS ose Schneider Electric.
Autoriteti Kontraktues KOSTI ka bere shkelje pasi qe ne baze te kësaj gjetje qe ka qene e kërkuar me dosje te tenderit e kane kualifikuar si te përgjegjshëm ku ne fakt do te duhet te ishte e kundërta dhe te shpallej i pa përgjegjshëm.

4. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data/or 220kV Circuit Breaker (Bus Coupler Bays)" tek pika 19 është kërkuar qe "across the distance 530kV(rms) ndërsa është ofruar 460 qe është ne kundërshtim me këtë pike ngase është kërkuar qe distanca te jete 530 e jo 460 sa është kërkuar.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOST si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 4-7 Technical Data for 220kV Circuit Breaker (Bus Coupler & Transformer Bays) Faqe 1 pika 19.

5. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data/or 220kV Circuit Breaker (Bus Coupler Bays)" tek pika 22 "across the isolating distance kV (peak) 1210 ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik 1050 kV(peak) qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.

Dokumenti i bashkangjitur Nr. 4-7 Technical Data for 220k V Circuit Breaker (Bus Coupler & Transformer Bays) Faqe 2 pika 22.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTI si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

6. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data/or 220kV Circuit Breaker (Bus Coupler Bays) .. tek pika 62 "Rated electrical endurance Class E2" ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik Class I qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.
Dokumenti i bashkangjitur Nr.4-7 Technical Data for 220kV Circuit Breaker (Bus Coupler & Transformer Bays) Faqe 4 pika 62,
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOST si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.

7. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data/or 220kV Circuit Breaker (Bus Coupler Bays)" tek pika 77 •. Minimum creepage distance to earth (20 mmlkV) mm 2460 ndërsa është ofru
ar nga operatori ekonomik 6140 qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 4-7 Technical Data for 220/(V Circuit Breaker (Bus Coupler & Transformer Bays) Faqe 5pika 77.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me paisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTI si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.

8. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data for 120kV Circuit F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK.

Breaker (OHL Bays)" tek pika 19 është kërkuar qe "across the isolating distance 530kV(rms) ndërsa është ofruar 460 qe është ne kundërshtim me këtë pike ngase është kërkuar qe distanca te jete 530 e jo 460 sa është kërkuar.
Dokumenti j bashkangjitur Nr. 8-11 Technical Data for 220" V Circuit Breaker (OHL Bays) Faqe 1pika 19. Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

9. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data for 220/CVCircuit Breaker (OHL Bays)" tek pika 22 .. across the isolating distance kV (peak) 1210 ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik 1050 kV(peak) qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Dokumenti i bashkangjitur Nr.8-11 Technical Data for 200 kv Circuit Breacer (OHL Bays) Faqe 2 pika 22. Opera tori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.

10. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data for 220kV Circuit Breaker (OHL Bays)" tek pika 62 "Rated electrical endurance Class E2" ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik Class E1 qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTI si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.

11. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e Technical data for 220kV Circuit Breaker (OHL Bays)" tek pika 77 .Minimum creepage distance to earth (20 mm/kV) mm 2460 ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik 6140 qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSIT.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 8-11 Technical Data for 220kV Circuit Breaker (OHL Bays) Faqe 5 pika 77. Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

12. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e 'Technicul data for 220kV OHL Disconnector with Earthing Switch" tek pika 20 "across isolating distance kV(peak) 1210 ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik 1200 qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 12 Technical Data for with Earthing Switch faqe 2 pika 20.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlersim nga KOSTI si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.
13. Operatori ekonomik Enbi Power ne pjesën e "Technical data fur 220kV Disconnector Switch tek pika 9 (. across isolating distance kV(peak) 1210 ndërsa është ofruar nga operatori ekonomik 1200 qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.

Dokumenti i bashkangjitur NT. 13 Technical Data for Switch faqe 2 pika 9.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.

14. Operatori Ekonomik Enbi power ne pjesën e Technical data for 1O(20)kV metal Clad Switchgear" tek pjesa technical data Schedule faqe 52 pjesa tek Busbar kerkohet qe .. rated current at 50°C (Corrosponding site rating) A 2500 ndërsa nga operatori ekonomik është ofruar 2500 ne 30 °C qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajise adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTI si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.

15. Operatori Ekonomik Enbi Power ne pjesën e 'Technical data for 10(20)kV Medium Voltage Technical data Schedule" ne piken 2.1.17 është kërkuar " Rated breaking current (asymmetrical) leA 40% d.c. comp. Ndërsa nga operatori ekonomik është ofruar 31% qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe eshte kerkuar dhe kjo pike nuk eshte evidentuar nga komisioni per vlerësim nga KOST si gjetje dhe qe eshte ne kundershtim me kerkesen e KOST.

16. 0peratori Ekonomik Enbi Power ne pjesen e .. Technical data for to(20)kV Medium Voltage Technical data Schedule" ne piken 6.12 është kërkuar qe Voltage Transformer in incoming bays and bus section bays. 14&15 1&11 secondary 30VA" ndërsa operatori ekonomik ka ofruar 5-10 VA qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOST.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 14-16 Technical Data for JO(20)kV MelaJ Clad Switchgear faqe 11pika 6.12.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me paisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSIT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSIT.

17. Operatori Ekonomik Enbi Power De pjesen - Technical Data for 35kV Disconnect Switch" pika 6 është kërkuar qe .. Highest Operating Voltage KV 40.5" ndërsa operatori Ekonomik ka ofruar 36kV qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 17 Technical Data for 354 V Disconnect Switch faqe 1pika 6.
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me paisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar riga komisioni per vlersim nga KOSIT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

18. Operatori Ekonomik Enbi Power ka plotësuar "Technical Data for 35kV
Current Transformer" qe ne baze te pyetjeve dhe përgjigjeve klarifikuese është hedhur poshtë pasi qe është dërguar Technical Data Sheet tjetër me karakteristika tjera. Operatori ekonomik i ka plotësuar dj data sheet te ndryshëm per te njëjtën pajisje qe është ne kundërshtimin me kërkesën edhe përgjigjet klarifikuese nga KOSIT.
Dokumenti i bashkangjitur Nr. 8 Technical Data for 35k V Current Transformer.

19. 0peratori Ekonomik Enbi Power ne pjesën Technical Data for 1O(20)kV Circuit Breaker" ne piken 26 kërkohet qe Temperature Class ·C -30 ..... +40" ndersa operatori ekonomik ka ofruar -5 . ... +40 qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

Dokumenti i bashkangjitur Nr. 19 Technical Data for JO(20)kV Circuit Breaker faqe 1pika 26.
Dokumenti I bashkangjitur Nr. 19.1 Climatic and Geological Conditions Ne specifikimet teknike ne gjuhen angleze tregon për kushtet klimatike ku do te ndërtohet nënstacioni ne Malisheve dhe për këtë arsye është kërkuar qe temperatura! te jene nga -3f1C ..... +4o"C
Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me paisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

20. Operatori Ekonomik Enbi Power ne pjesën (technical Data for 10Kv Disconnect Switch" ne piken 10 kërkohet qe " Rated current A 2500" ndërsa OE ka ofruar 800A qe është ne kundërshtim KOSTT, Operatori Ekonomik nuk ka ofertuar me pajisje adekuate qe është kërkuar dhe kjo pike nuk është e evidentuar nga komisioni për vlerësim nga KOSTT si gjetje dhe qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTI.

21. Operatori Ekonomik Enbi Power ne pjesën .. Technical Data for 10(20)Kv Voltage Transformers equipped with primary fuses" ne piken 13 kërkohen qe Accuaracy class rating and capacitiv of metering/protection-windings cl.0210VA. cI 0.S13P ISVA, cl. 0.S/3P 15VA'. ndërsa operatori ekonomik ka ofruar c1.0.2 5-IOVA, cl. 0.5/3p. 5-10 VA cl. 0.5/3P 5-IOVA qe është ne kundërshtim me kërkesën e KOSTT.

22. Sipas vlerësimit tone ne baze te gjeturave ne dosjen e operatorit ekonomik Enbi Power ka devijime thelbësore te cilat direkt prekin kualitetin e thelbit te projektit ku ne vlere monetare ka devijime mbi 30% prandaj është e pa kuptimtë nga ana e komisionit te bëhen mbi 39 pyetje sqaruese një operatori me kaq shume gabime te gjetura për te cilat ligji i prokurimit jep sqarime te sakta. Andaj kërkojmë nga KOSTI qe te beje rishqyrtimin e këtij vendimi dhe i njëjti te shpallet i pa përgjegjshëm.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "Doko" LOT 3.

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP - Qëllimi
- Neni 6 i LPP – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP - Barazia ne trajtim /jo - diskriminim
- Neni 27 i LPP – Dosja e tenderit
- Neni 28 i LPP – Specifikimet teknike
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 65-71 i LPP-së
- Neni 39 i RRUOPP

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta

Kompania 'OOKO' sh.pk, pas analizimit te tërësishëm te dokumenteve relevante te Tenderit per: Furnizimi dhe instalimi iNS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP, Lot 3: Ndertimi i nen- stacionit te ri - AIS 220 35 10 (20) kV Malisheva me linjen përcjellëse 220 kV, konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues - KOSTT SH.A, ka bere shkelje ligjore ne mos vlerësimin e drejte, ligjor dhe objektiv te Ofertes sone qe eshte Oferte për formuese dhe Oferte e përgjegjshme ne pajtim te plote me kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara ne Dosje te Tenderit.

Pikat e Ankesës për shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues janë te prezantuara si vijon:

1. Autoriteti Kontraktues, me datën 24.11.2020, nëpërmjet portalit E-prokurimi te KRPP-se, publikon Njoftimin mbi Vendimin për Njoftim për Dhënie te Kontratës per prokurimin: Furnizimi dhe instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP, Lot 3: Ndërtimi i nen-stacionit te ri - AIS 220 35 10 (20) kV Malisheva me linjën përcjellëse 220 kV.

2. Kompania 'OOKO' shpk, pas publikimit te Njoftimit mbi Vendim për Dhënie te Kontratës, me datën 27.11. 2020, ka përgatitur dhe dorëzuar Kërkesën për Ri-shqyrtim ne Autoritetin Kontraktues.

Ne Kërkesën për Ri-shqyrtim, keni listuar argumente te mjaftueshme ligjore qe Oferta e Kompanisë 'DOKO' shpk është Oferte e përgjegjshme dhe ne pajtim me kërkesat, kushtet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu, ne Kërkesën për Rishqyrtim, kemi potencuar se nuk ka asnjë 'kërkesë' e detajuar per Terminalet e Kabullit te Tensionit te Mesem ngase kjo KERKESE nuk është 'specifikuar' ligjërisht De mënyrë specifike dhe adekuate as ne Kërkesat Teknike dhe as ne Specifikacionet Teknike te Detyrueshme ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen angleze te Dosjes se Tenderit ne mënyrë qe ky Data Sheet (Fleta e te Dhënave) per Kabllot te i përmbajë 'parametrat' minimale qe do te kishte kërkuar Autoriteti Kontraktues ne vet Dosje te Tenderit.
Prandaj, per fat te keq, Oferta e Kopanisë 'DOKO' shpk refuzohet dhe shpallet e pa-përgjegjshme dhe nuk vlerësohet drejte dhe ligjshëm nga KOSTT per nje 'kerkese' qe nuk eshte specifikuar 'qarte' ne Dosje te Tenderit dhe qe per te njëjtën Kërkesë pa asnjë pengese ose kufizim Ligjor sipas nenit 28 te Dosjes se Tenderit dhe sipas nenit 72 ka mundur te kërkojë sqarime nga Kompania 'DOKO' shpk:
Ne Kërkesën për Rishqyrtim, keni prezantuar, si fakt kryesor, Data Sheet per Kabllot e Tensionit te Mesëm me te gjitha parametrat e nevojshme teknike si dhe informacionet për prodhuesin e Kabllove.
Autoriteti Kontraktues, pas marrjes se Data Sheet per KabUot te kompletuar nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim ka mundur te beje ekzaminim/verifikim tek Prodhuesi ose te marre sqarime shtese nga Kompania 'DOKO' shpk por nje veprim te tille nuk e kane ndërmarrë edhe pse kane obligim ligjor qe cdc Oferte te vlerësojnë, krahasojnë dhe verifikojnë ne aspektin teknik, ligjor dhe financiar sipas nenit 59 dhe 72 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosovës;

3. Autoriteti Kontraktues, me datën 02.12.2020, ka dorëzuar vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim. Ne vendimin e kërkesës per rishqyrtim, AK jep arsyetime te pa bazuara dhe pa argumentuara me vetim nje konstatim te bazuar sipas mendimit te kompanisë tone, i mohohet e drejta e fitimit te kontratës publike ne menyre te rregullte dhe ligjore dhe nuk jep asnje përgjigje ligjore ne te gjitha pikat tona te pretendimeve ankimore dhe pa asnje detyrim ligjor sipas nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit me nr. 04/ L - 042 dhe sipas nenit 8 te Rregullave për parashtrim te ankesave.

4. Ne ndërlidheshmëri, me piken 2 dhe 3 te Ankesës, Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje ligjore re nenit 27, 28 dhe nenit 69 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L - 042 dhe nenit 39 te Udhëzuesit Operativ per Prokurim Publik per arsye se vlerësimi i Ofertueseve behet 'eksluzivisht' kundrejt KERKESAVE qe janë te specifikuara ne Fleten e te Dhënave te Dosjes se Tenderit dhe ne specifikacionet teknike te detyrueshme ne gjuhen angleze dhe aftësitë teknike dhe profesionale.
Autoriteti Kontraktues, ne menyre profesionale, nuk i ka qartësuar drejte dhe ne mënyrë specifike kërkesat teknike për Kabllot e Tensionit te Mesem dhe per mos qartësim te kërkesës për Kabllot e Tensionit te Mesëm është Jo-ligjore dhe e padrejte qe te refuzohet Oferta e Kompanisë DOKO' shpk ngase ka përvojë shume vjeçare ne ndërtim te nen-stacioneve te linjave te energjisë elektrike brenda dhe jashtë shtetit me staf te kualifikuar teknik dhe ka aftësi teknike për implementim te kontratës publike ne afatin e parapare ligjor te realizimit te projektit.

5. Ne nderlidhshemeri, me piken 4 te Ankesës, Kompania 'DOKO' shpk, ri-potencon se Kabllot e Tensionit te Mesëm jane pjese përbërëse e vet Projektit dhe e Specifikacionit Teknik te Detyrueshëm ne gjuhen angleze dhe shqipe.
Ne këto 2 specifikacione teknike, si pjese përbërëse, e Dosjes se Tenderit, potencohet rëndësia e kabllove ne përgjithësi për ndërtimin e nen-stacionit ne Malisheve dhe si produkt mjaft i rëndësishëm ne realizim te projektit, Autoriteti Kontraktues, ka pasur obligim ligjor sipas nenit 28 te dosjes se Tenderit dhe sipas nenit 72 te kërkojë Sqarim ligjor' nga Kompania DOKO' shpk për Parametrat' teknike për Kabllot e Tensionit te Mesëm dhe çdo sqarim i ofruar do te përmbante te gjitha parametrat e nevojshme teknike qe e siguron Autoritetin Kontraktues per cilësinë dhe standardin e larte te Kabllave te Tensionit te Mesëm qe do te përdoren për realizim te projektit te nen-stacionit ne Komunën e Malishevës.

Sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L - 042, Autoriteti Kontraktues, gjate procesit te vlerësimit te ofertave ka obligim ligjor qe te vlerësojë, krahasoje dhe ekzaminoje Ofertën e Kompanisë 'DOKO' shpk ne çdo aspekt teknik, ligjor dhe financiar.

Ne rastin konkret, anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave, nuk kane bere 'ekzaminimi' te Ofertës sonë kundrejt specifikacionit teknik te detyrueshëm, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit sepse 'verifikimi' ka qene i domosdoshëm për te ardhur ne konstatim ligjor qe Oferta e Kompanisë 'DOKO' shpk eshte Oferte e përgjegjshme dhe ne pajtueshmëri te plote me kërkesat teknike te potencuar ne Dosje te Tenderit.
Me 'ekzaminim' nënkuptojmë 'verifikim' te gjendjes faktike dhe sl rrjedhoje procesi i vlerësimit te ofertës sonë nga Autoriteti Kontraktues është Jo-ligjor, subjektiv dhe jo profesional.
Si rezultat i saj, edhe njëherë ri-potencojmë se Oferta e Kompanisë 'DOKO' shpk është e Oferte e përgjegjshme, për formuese dhe produktet e ofruara me Oferte janë plotësisht funksionale, ashtu sic kërkohet me nenin 28 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe ashtu siç kërkohet me Specifikacionet Teknike te Detyrueshme, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit dhe nuk do te paraqiste asnjë problem gjate implementimit te kontratës publike.

6. Autoriteti Kontraktues, ka shkelur edhe nenin 1, 2, 6 dhe 7 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L - 042 ngase po diskriminohet rende Kompania 'DOKO' shpk ne mos vlerësimin e drejte dhe Ligjore te ofertës sonë te përgjegjshme nga ana e komisionit vlerësues te Autoritetit Kontraktues.

7. Kompania 'DOKO' shpk garanton per cilësinë e produktit qe ri-konfirmon qe pro ofruar ne Ofertën tone është ne pajtim te plote me specifkacioneve teknike te de dosjes se tenderit (pjese e specifikacionit teknik te detyrueshëm)dhe nuk ka performancen dhe funksionalitetin e produktit te kërkuar nga KOSTT SH.A. dhënat teknike re kabllove te tensionit te mesëm ekzistuese para Njoftimit te Kontratës ne përputhje me te gjitha standardet ndërkombëtare.

8. Kompania 'DOKO' shpk, do te paraqese, faktet konkrete, si pjese te argumentimit ligjor për te i mundësuar OSHP-se shqyrtimin e drejte dhe ligjor te argumenteve te prezantuara ne Ankese duke filluar me dorëzimin e Data Sheet (Fleta e te Dhënave) per parametrat teknike qe përmban Kabulli i Tensionit te Mesëm dhe ekstraktet e neneve te shkelura nga Autoriteti Kontraktues.

Përfaqësuesit e Kompanisë 'DOKO' shpk janë ne dispozicion per te ofruar sqarime profesionale teknike si per Ekspertin Teknik te OSHP-se par edhe per anetaret e OSHP-se gjate shqyrtimit te argumenteve tona ligjore me shpjegime konkrete ligjore dhe teknike ne menyre qe te bindet Paneli Shqyrtues ne shkeljet ligjore te Autoritetit Kontraktues per refuzirn te Ofertës sonë qe është Oferte për formuese dhe Oferte e përgjegjshme ne pajtueshmëri te plote me kërkesat dhe kushtet teknike te potencuar ne Dosjen e Tenderit; dhe

9. Autoriteti Kontraktues, pas deponimit te kërkesës për qasje publike, ka ofruar qasje publike duke marre kopjen e Raportit te Vlerësimit te Ofertave.
Ne faqen 7 te Raportit te Vlerësimit te Ofertave ceket se ne Ofertën e Kopanisë 'DOKO' shpk se ... citat .... 'vlerësim i Ofertës teknike te O.E lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat teknike te kërkuara ne dokumentin e specifikimit teknik .... mbyllje citati, i epet vetëm nje përshkrim i përgjithshëm dhe Jo specifik dhe Jo /igjor gje qe është ne kundërshtim me nenin 59 te Ligjit te Prokurimit Publik sepse e tere Oferta jone teknike eshte ne pajtueshmëri te plote me 'kërkesat teknike te specifikuara ne Fleten e te Dhenave te Tenderit si dhe ne specifikacionet teknike te detyrueshme ne gjuhen angleze dhe ne gjuhen shqipe, Aneks 1 i Dosjes se Tenderit,

Ne anën tjetër, ne faqen 12 te Raportit te Vlerësimit te Ofertave qe ndërlidhet me arsyet e përgjithshme te cekura ne faqen 7 te po te njëjtit Raport ceket se mungon Datasheet për kabull është pjesërisht e pa plotësuar (mungon pjesa për MV power cableterminations)dhe qe Kompania 'DOKO' ka ofruar 3 teknologji për mbrojte, kontroll dhe SCADA.
Autoriteti Kontraktues, sic kemi potencuar ne argumentet ligjore te potencuar ne pikat 1 deri 8 te Ankesës, ka bere shkelje ligjore te nenit 38 te Dosjes se Tenderit, nenit 59 dhe nenit 72 te Ligjit te Prokurimit Publik, nt. 04 / L - 042 dhe nenit 39 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik sepse nuk ka kërkuar 'sqarim lisior' nga Kompania 'DOKe)' shpk ngase 'Kabllot' e tensionit te mesëm janë pjese e pandashme te specifikacionit teknik dhe pjese e Ofertës teknike te dorëzuar ne KOSTT SH.A.
Kompania 'DOKO' shpk do te ofronte informatat dhe sqarimet e nevojshme per parametrat teknik te Kabllove te tensionit te mesëm dhe pas sqarimeve te ofruara, Autoriteti Kontraktues, do te merrte vendim për te shpallur ofertën tone si oferte e përgjegjshme dhe te konsiderohet potencialisht oferte për fitim te kontratës publike pasi ne tërësi Oferta është ne pajtim me kërkesat dhe kushtet e dosjes se tenderit.

Ne fund, ri-potencojme argumentin ligjor se është Jo ligjore dhe e kundërligjshme qe Autoriteti Kontraktues ne baze te raportit te vlerësimit te ofertave dhe ne Letrën për Tenderuesin e Eliminuar pa ofruar 'arsyetimin ligjor' te bazuar ne ndonjërën nga dispozitat ligjore te Ligjin e Prokurimit Publik, Dr. 04 / L - 042, Udhëzuesit Operativ per Prokurim Publik dhe ne asnjë dispozite ligjore ne Dosje te Tenderit.
Prandaj, Kompania 'DOKO' shpk, e konsideron si Raportin e Vlerësimit te Ofertave dhe Vendimin per eliminim nga aktivitetit i prokurimit per Lot 3, si vendim subjektiv dhe jo ligjor, i marr nga Autoriteti Kontraktues.
Shënim për argumentet ligjore te potencuar ne Ankese dhe faktet e bashkëngjitura:
Ne pajtim me Rregulloren per Trajtimin e Ankesave dhe sic parashihet edhe me nenin 1 te Prokurimit Publik pretendimet ankimore janë te njëjta ku si parashtrues i Anke arsyetimet tona ligjore dhe mos pajtimet ne arsyetimet e ofruara ne Vendimin për Re për Rishqyrtim kundrejt argumenteve ligjore te potencuar ne Kërkesën për Rishqyrtim.
Ne parashtrim te Ankesës ne OSHP bëjmë edhe deponimin e provave relevante materiale me numër rendor për te i ofruar argumente te mjaftueshme ligjore si eksperteve por edhe anëtarëve te panelit shqyrtues te OSHP-se për te konstatuar drejte dhe Ligjshëm gjendjen faktike për lenden e kontestuar.
Përfaqësuesit ligjor te Kompanisë si parashtrues te Ankesës ne OSHP janë ne dispozicion qe sipas Rregullores se Punës se OSHP-se por edhe ne baze te nenit 108 I A te Ligjit te Prokurimit Publik te ofroje sqarime ligjore lidhur me përmbajtën e argumenteve tona dhe provave te potencuar ne Ankese para Ekspertit dhe Panelit Shqyrtues po qesë kërkohen sqarime lidhur me përmbajtën e Ankesës.
Prandaj, mos vlerësimi i drejte dhe ligjor, ashtu siç kërkohet sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe mos fitimi potencial i nje kontrate publike ne mënyrë te rregullte ndikon ne shpenzime I gjore, humbje te fitimit real nga mos realizimi i projektit, si dhe reputacioni i Kompanisë sonë ne tregun konkurrues te Kosovës.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezantimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania 'DOKO' shpk kërkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne mënyrë ligjore duke marre Vendim per te ktbyer lenden e kontestuar ne RI· VLERESIM te OFERTAVE, ne menyre qe Autoriteti Kontraktues - KOSTI SH.A, te beje vlerësim te serishëm te ofertave me anëtar te rinj te komisionit vlerësues dhe te shpall fitues Kompaninë 'DOKO' shpk, qe ka plotësuar te gjitha kushtet, kërkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues te potencuar ne Dosje te Tenderit.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "G3 Inxhinering" LOT 3.

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP - Qëllimi
- Neni 7 i LPP - Barazia ne trajtim /jo - diskriminim
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies se kontratës
- Neni 64 i LPP-së – Dëshmitë e kërkesave
- Neni 69 i LPP-se - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta

Te nderuar ne me datën 24.11.2020 përmes E-prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe letrën standarde, ku për LOT 3, AK-KOSTT është rekomanduar për kontrate OE "ENBI POWER" SHPK.
Fillimisht ju sqarojmë se ne me datën 25.11.2020 kemi pasur qasje ne dokumentacionin zyrtar.
Autoriteti kontraktues ka vendosur specifika kundërthënëse ne Data Sheet-a ne D.T si ne vijim:

10(20) kV Metal Clad Switchgear

Tek data sheet: 10(20) kV Medium Voltage Technical Data Sheet

5. Current Transformer

5.12. Rated short-time eithstand current: është kërkuar 25 kA per 1s
Ndërsa tek: Technical Data for 10(20) kV Current Transformer — qe është i njëjti produkt ka kërkuar:
9. Short-circuit breaking current: 25 kA 10.
Short-circuit time: 3s
Tek: DC Batteries and UPS System
1.8 Type of cell, keni kërkuar Nicel-Cadmium, ndërsa

Tek: Technical Data for Batteries
4. Type, keni kërkuar VRLA (OPZV) Maintenance Free

Tek: Technical Data Schedule UPS-System
1.10 Rated outputs: eshte kerkuar 3 kVA, ndersa
Tek: Technical Data for Uninterruptible Power Supply (UPS)
9. Rated power: është kërkuar 5 kVA
Specifikat e lartcekura te vendosura nga AK-ja janë kundërthënëse sepse për produkte te njëjta ka bere kërkesa te ndryshme.
Ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontrate për Lot 3 një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si ne vijim:
OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike te përcaktuara ne dosje te tenderit përkatësisht Tek tabela 15 ku shihet qarte se ne çmimore janë 10 pozicione, ndërsa janë plotësuar vetëm 9 pozicione nga ana e OE te rekomanduar per kontrate, pra mungon nje pozicion, pozicioni 15.5- Kokat kabllovike për kyçje, qe tregon qartë faktin se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm dhe është dashur te cilësohet si i tille nga AK-ja, mirëpo përkatësisht qe një veprim te tille nuk e ka bere përderisa e ka rekomanduar për kontrate.
OE i rekomanduar per kontrate është i papërgjegjshëm edhe per faktin se nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike përkatësisht tek Technical Data for 10(20) kV Medium Voltage .

Technical Data Schedule

2.1 Circuit Breaker.

2.1.17 Rated breaking current (asymmertrical) — ku është është kërkuar 40% d.c. comp — ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar 31%.
Pra shihet qarte se OE i rekomanduar per kontrate ne lidhje me pozicionin e lartcekur nuk ka ofertuar konform kërkesës se lartcekur, pasi qe nuk e ka ofruar përqindjen e kërkuar prej 40% sa i përket pozicionit 2.1.17, mirëpo ka ofertuar me nje përqindje me te ulet, pra përqindje prej 31%, qe tregon qarte faktin se ky OE eshte i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek pozicioni 2.1.28 Maximum time interval between opening of interrupters of one phase — ku intervali i kërkuar është 3 ms, ndersa OE i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me intervalin 63. Pra ky fakt e tregon qarte papërgjegjshmërinë e OE te rekomanduar per kontrate, pasi qe nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike Po ashtu OE i rekomanduar per kontrate është i papërgjegjshëm edhe per faktin se tek pozicioni 2.1.34 Mechanical life of circuit breaker and mechanism in, ku është kërkuar No. of operation — 100,000, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka ofruar 30,000. Pra edhe ne kete pozicion OE i rekomanduar per kontrate nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike, fakt ky qe tregon edhe nje here papërgjegjshmërinë e OE te rekomanduar per kontrate.

OE i rekomanduar per kontrate është i papërgjegjshëm edhe per faktin se tek pozicioni 5.15
Current transformer- bërthama e pare dhe e dyte janë kërkuar te jene me shkalle saktësie 0.2s ndërsa tek katalogu i ofruar nga ana e OE te rekomanduar për kontrate shihet qarte se shkalla e saktësisë është 0.2, pra nuk ka ofertuar me shkalle saktësie ashtu siç është kërkuar 0.2s, mirëpo është ofruar vetëm 0.2 qe nuk dihet se për çfarë është fjala.
Tek pozicioni 6.12 Voltage transformer
14. I secondary është kërkuar 30 VA, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 5-10 VA

15. II secondary është kërkuar 30 VA ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 5-10 VA.
Shihet qarte se edhe ne kete pozicion OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofertuar ashtu siç është kërkuar dhe është dashur te shpallet i papërgjegjshëm nga ana e AK-se.
OE i rekomanduar per kontrate edhe tek pjesa DC Batteries and UPS System pozicioni 1.8. Type of cells per battery unit — ku është kërkuar Nickel-Cadmium, ka ofruar VRLA GEL Pb, pra nuk ka ofertuar konform kërkesës se lartcekur. Pra përderisa është përcaktuar lloji i qelizave për njësinë e baterisë, atëherë është dashur te ofertohet me atë lloj dhe jo me tjetër siç ka ofertuar OE i rekomanduar për kontrate.

OE i rekomanduar për kontrate tek Bus Rise Cubicle data sheet poz. 4. Rated Voltage, ku është kërkuar qe tensioni i vlerësuar te jete 24kV and 35kV, ka ofruar vetëm tensionin 24 kV, ndërsa shihet qarte se është kërkuar 24 kV dhe 35 kV, mirëpo OE i rekomanduar për kontrate ka ofertuar vetëm me 24 kV, fakt ky qe tregon qarte papërgjegjshmërinë e OE te rekomanduar për kontrate.
Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe per faktin se tek Technical Data for 10(20) kV Current Transformer poz.16. ku shkalla e saktësisë është kërkuar 0.2s, ndërsa ne katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar per kontrate shihet qarte se shkalla e saktësisë .2, pra nuk është 0.2s siç është kërkuar.
Tek Technical Data for 35 kV Disconnect Switch tek pozicioni 6. Highest Operating Voltage - është kërkuar te jete 40.5 kV, ndërsa OE i rekomanduar per kontrate për ketë pozicion ka ofertuar me 36 kV, ndersa tek pozicioni 8. Rated power-frequency withstand voltage eshte kërkuar 80 kV, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 70 kV, pra nuk ka ofertuar siç është kërkuar.

OE i rekomanduar për kontrate tek Technical Data for 10 kV Disconnect Switch poz.10. Rated current — ku është kërkuar 2500 A, ka ofruar 800 A. Ndërsa ne katalogët e ofruar nuk ekziston varianti me 2500 A për

ndarës, per llojin e kthinës se ofruar, andaj OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofertuar sipas variantit te kërkuar dhe është i papërgjegjshëm.
Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek Technical Data for 10(20) kV Voltage Transformers equipped with primary fuses poz. 13 Accuracy class rating and capacity.... Ku është kërkuar qe fuqia per dy berthamat e fundit te jete 15 VA, ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar 5-10 VA. Pra edhe tek ky pozicion OE i rekomanduar per kontrate nuk ka ofertuar ashtu siç është përcaktuar, qe tregon qarte edhe nje here faktin se OE i rekomanduar per kontrate është i papërgjegjshëm.
Duke u bazuar ne te gjitha faktet e lartcekura ne jemi te habitur se si AK-ja e ka rekomanduar per kontrate nje OE i cili është i papërgjegjshëm, andaj ky veprim i AK-se nuk mund te kuptohet ndryshe nga ana jone pervec se favorizim i hapur ndaj OE te rekomanduar per kontrate, pasi qe nuk ka mundësi te rekomandohet për kontrate nje OE i cili nuk ka ofertuar sipas specifikimeve teknike. Gjithashtu është i habitshëm fakti se si ka mundësi te rekomandohet per kontrate nje OE i cili nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike nga ana e AK-se, përderisa vete AK-ja i ka hartuar këto specifikime.

Gjithashtu edhe OE ELECTRA SH.P.K, i renditur si i dyti me çmim me i lire për lot 3 është i papërgjegjshëm për faktet si ne vijim:
OE i lartcekur tek Technical Data for 10(20)kV Medium Voltage Technical Data Schedule
Poz.2.1 Circuit Breaker; 2.1.17 Rated breaking current (asymmertrical) ku është kërkuar 40% d.c. comp, ndërsa OE i lartcekur ka ofruar 40%, mirëpo ne baze te tipit te ndërprerësit dhe prodhuesit përqindja e komponentëve dc eshte 31%, pra nuk ka ofertuar konform kërkesës tek specifikimet teknike dhe është i papërgjegjshëm.
Po ashtu tek pozicioni 2.1.28 Maximum time interval between opening of interrupters of one phase është kërkuar 3 ms, ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar 63, pra nuk ka ofertuar ashtu siç është përcaktuar.
Po ashtu edhe tek pozicioni nr.2.1.32 Maximum time interval between closure of first and last phase of three-phase circuit breaker— është kërkuar 3 ms, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 63.

OE i rekomanduar për kontrate është i përgjegjshëm edhe per faktin se tek poz. 2.1.34 Mechanical life of circuit breaker and mechanism in No. of operation ku është kërkuar 100,000, OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar 100,000, mirëpo ne baze te tipit te ndërprerësit dhe prodhuesit operimet maksimale janë 30,000.

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek Technical Data for 10 kV Disconnect Switch tek poz.10. Rated current ku eshte kerkuar 2500 A,
OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar 2500 A.
Ndërsa ne katalogët e ofruar nuk ekziston varianti me 2500 A per ndares, per llojin e kthines se ofruar.
Po ashtu OE te lartpërmendur i mungon katalogu per transformator matës te rrymës dhe tensionit 10(20) kV, dhe ne baze te data sheet prodhuesi i ofruar nuk ofron shkalle saktësia 0.2s.
Gjithashtu OE te lartpërmendur i mungojnë edhe katalogët për: UPS, IN Switchgear, AC Distribution Board, 110 VDC and 48 VDC Distribution Boards, CCTV.
Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qarte se OE ELECTRA SH.P.K është i papërgjegjshëm dhe është dashur te cilësohet si i tine nga ana e AK-se dhe jo te cilësohet si OE i pasuksesshëm.

Gjithashtu ju sqarojmë se OE i rekomanduar ELECTRA SH.P.K janë te papërgjegjshëm specifikimet teknike tek:
Kapitulli 4— Detailed Technical Requirements
4.10 Station Control System (SCS)
4.10.3 Specific Experience
Participation as contractor or as a partner of this contract should be have at least four (4) contracts (These can

include contracts referenced under sub-criterion General Experience) for design, supply and construction/rehabilitation of SCS for 220/xx kV or higher voltage level substations and have been successfully and substantially completed SCS within the last ten (10) years and within ENTSO-E grid.
Every Application for SCS should be have:

1. IEC 62443 (Cyber security accreditation) Providing accredited certificate for IEC 62443 industrial standard for SCADA system providing compliance to best cyber security practices related to SCADA engineering processes.
2. Cyber security risk assessment and penetration testing of the PVPP control system Risk assessment and penetration testing of the substation control system in order to be compatible with the ISO 27001 and IEC 62443 requirements

OE ENBI POWER SH.P.K i rekomanduar per kontrate dhe OE ELECTRA SH.P.K i shpallur si OE i pasuksesshëm nuk e përmbushin kërkesën e lartcekur, per faktin se ne njeren nga pyetjet klarifikuese, eshte pyetur se a është kërkesa e lartcekur kërkesë e detyrueshme, dhe përgjigja e AK-se ka qene afirmative. me saktësisht, pyetja ka qene si ne vijim:

- Pyetja: "A janë obligative ne përzgjedhje te tenderit kërkesat e paraqitura ne kapitullin 4, te dokumentit për specifik a?"

Ndërsa AK-ja ka dhënë përgjigje si ne vijim:

- Përgjigja: Te gjitha përshkrimet kërkesat ne specifikim teknik janë obligative.

Duke u bazuar ne pyetjen dhe përgjigjen e lartcekur OE te lartpërmendur Janë te papërgjegjshëm sepse edhe përkundër përgjigjes se lartcekur te AK-se, nuk kane ofertuar konform kërkesës pasi qe nuk i kane plotësuar Kërkesat e hollësishme teknike 4.10 Sistemi i Kontrollit te Stacionit (SCS) dhe 4.10.3 Përvoja specifike.

Andaj është per tu habitur se si AK-ja i ka cilësuar si te përgjegjshëm respektivisht te rekomanduar per kontrate OE përderisa vete ajo e ka cekur se te gjitha përshkrimet/kërkesat ne specifikimet teknike janë obligative,
Sa i përket arsyes se AK-se për eliminimin tone ju sqarojmë se ne lidhje me çmimoren e ofruar nga ne, ne kolonën 11, e cila u be shkas i eliminimit tone nga procesi i tenderimit, AK-ja ka krijuar dykuptimësi. Kolona 11 është pothuajse plotësisht e ngjashme me kolonat ne te cilat është kërkuar vendosje e çmimit dhe është totalisht e ndryshme nga kolonat ne te cilat nuk është parapare vendosje e cenimit. Pikat ne vazhdim ilustrojnë detajisht këtë pohim:

- Se pari, te gjitha kolonat me tekst ne gjuhen shqipe, dhe te cilat nuk kane ngjyre ne sfond, kane qene pozicione ne te cilat është kërkuar vendosja e çmimit.
- E dyta, ne te gjitha kolonat me tekst ne gjuhen shqipe, dhe te cilat nuk kane ngjyre ne sfond, eshte specifikuar sasia. Rshte indikativ fakti se ne kolonën 19 — teksti i te cues është ne gjuhen angleze, i nxire, dhe ne te cilën nuk është specifikuar sasia ne nuk kemi vendosur çmim fare.
- Se treti, ne te gjitha kolonat me tekst ne gjuhen shqipe, vendosja e katroreve per caktim te çmimit — e percjellur me mungese te ngjyrës ne sfond ka nënkuptuar se aty duhet te vendosen çmimet.
- Se katërti, te gjitha kolonat me tekst te nxire kane përfaqësuar pozicione ne te cilat nuk është dashur te vendoset cmimi.

Pra, ne kolonën 11, shihen qarte këto karakteristika:
1) teksti shqip
2) mungesa e ngjyrës ne sfond
3) vendosja e sasisë
4) vendosja e katroreve për caktim te çmimit
5)Mungesa e nxirjes se tekstit

Te gjitha këto karakteristika janë identike me kolonat ne te cilat eshte kërkuar vendosje e çmimit.
I vetmi dallim i kolonës 11, me kolonat ku është kërkuar vendosje e cmimit, është se ne rreshtin B, ne kolonën 11 mungon numri rendor. Mirëpo, duke qene te vetëdijshëm per ekzistencën e gabimeve te shumta ne cmimore, ne kemi konsideruar arsyeshëm qe mos-vendosja e numrit rendor nga ana juaj ka qene lëshim teknik. Për te vërtetuar këtë pohim tonin, ne kërkojmë te shikohet kolona 99, ne te cilën nuk është specifikuar numri rendor. Nese analizohet kolona 11 me kolonën 99, shihet qarte se ato jane identike.
Andaj duke e pare se kolona 11 është 83.33% (apo 5/6) e ngjashme me kolonat ne te cilat është kërkuar vendosje e çmimit;
duke e pare se kolona 11 është totalisht e ndryshme nga kolonat ku nuk është kërkuar vendosje e çmimit; dhe duke e pare se karakteristika e gjashte (16.66%) nuk është aplikuar ne mënyrë rigoroze (shih: kolonën 99), ne kemi konsideruar arsyeshëm se ne kolonën 11 duhet te vendoset çmimi.
Konflikti mes kolonës 11 te cmimores, ne te cilën kërkohet vendosje e çmimit, dhe asaj çka AK-ja ka pasur ne mendje, ne rastin me te bute mund te interpretohet si ekzistence e dykuptimësisë. Per këtë arsye, tenderi duhet te anulohet. Gjithashtu cmimorja përmban pozicione te dyfishta, pasi qe pozicionet ne kategorinë me numër 13 ne pjesen elektrike janë identike me pozicionet ne kategorinë 2 ne punët ndërtimore. Per ilustrim, shih këta shembuj:
1.
- **Pozicioni 13.3, Pjesa Elektrike**. Fumizimi dhe instalimi i kabllove me fiber optike nentokesore (OFC) me fibra 48 + 48 (ITU-T G.655D) nga kantieri i ri i nënstacionit Malisheva 220/35/20(10) kV ne OMDF te ri (komiza optike kryesore e shperndarjes) ne ndertesen e kontrollit, duke perfshire te gjitha nyjet, kutite e bashkimit dhe pajisjet.
- **Pozicioni 2.3, Punët Ndërtimore**. Instalimi dhe vënia ne funksionim e kabllove me fibër optike nëntokësore (OFC) me fibra 48 + 48 (ITU-T G.655D) nga kantieri i ri i nënstacionit Malisheva 220/35/20(10) kV ne OMDF te re (korniza optike kryesore e shpërndarjes) ne ndërtimin e kontrollit, përfshirë te gjithë aksesoret dhe pajisjet.
2.
- **Pozicioni 13.5, Pjesa Elektrike**. Njësi te izolatorëve te përberë me amortizim te dyfishtë komplet me te gjithe aksesoret dhe pajisjet.
-**Pozicioni 2.5, Punët Ndërtimore**. Njësi te izolatorëve te përberë me amortizim te dyfishte komplet me te gjithë aksesoret dhe pajisjet.
3.
-**Pozicioni 13.7, Pjesa Elektrike**. Amortizatorë vibrimi te llojit Stockbridge, te përshtatshëm për përçuesin fazor 490/65 mm2.
-**Pozicioni 2.7, Punët Ndërtimore**. Amortizatorë vibrimi te llojit Stockbridge, te përshtatshëm për përçuesin fazor 490/65 mm2.
4.
- **Pozicioni 13.8, Pjesa Elektrike**. Amortizatorë vibrimi, te përshtatshëm për OPGW.
- **Pozicioni 2.8, Punët Ndërtimore**. Amortizatorë vibrimi, te përshtatshëm për OPGW.

Ne konsiderojmë se vendosja e nje pozicioni dy here brenda cmimores përbën dëmtim material te integritetit te procesit te tenderimit pasi qe krijon dykuptimësi, hapësirë te madhe per komplikime, dhe dëme tjera. Si rezultat, ne konsiderojmë se ky argument si i vetëm mjafton për anulim te tenderit.

Pra duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qarte se specifikimet teknike-para masa ne gjuhen shqipe dallon me ate ne gjuhen angleze edhe pse është dashur te jene te njëjta. Andaj shihet qarte se AK-ja ka bere gabime ne hartimin dhe përpilimin e dosjes se tenderit ne gjuhen shqipe dhe ate angleze pasi qe nuk janë te njëjta dhe ne konsiderojmë se duhet te behet anulimi i këtij aktiviteti te prokurimit, pasi qe ne po diskriminohemi ne këtë

aktivitet te prokurimit nga ana e AK-se me gabime te saj. Andaj ne nuk mund dhe nuk duhet te pësojmë nga gabimet e AK-se dhe te përfitojnë OE te papërgjegjshëm duke u rekomanduar për kontrate.
Pasi qe ne kemi analizuar dhe e kemi ofertuar me dosjen ne gjuhen shqipe e qe është normë qe ne kemi ofertuar ne këtë mënyrë atëherë nuk mund te eliminohemi me arsye se ne gjuhen angleze ka dallime emimorja, prandaj ne nuk duhet te pësojmë nga gabimet e AK-se por duhet te trajtohemi ne mënyrë te barabarte ose eventualisht te anulohet ne tërësi ky aktivitet i prokurimit për këto gabime te AK-se.

Ne me dt.02.12.2020 kemi mane përgjigje ne kërkesën per rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore ne pretendimet tona ankimore.
AK-ja ne arsyen e refuzimit te kërkesës tone per rishqyrtim ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsyetim ne lidhje me pretendimet tona ankimore, fakt ky qe tregon qarte se pretendimet tona ankimore janë te bazuara dhe qëndrojnë. Pasi qe nëse pretendimet tona ankimore do te ishin te pa bazuara atëherë AK-ja do ta dëshmonte me fakt te se arsyetimet tona ankimore janë te pa bazuara, mirëpo qe nje veprim i tille nuk është bere nga ana e AK-se qe tregon qarte faktin se pretendimet tona janë te bazuara.

Duke u bazuar ne te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, sepse është rekomanduar per kontrate OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës e qe ka gene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet sic parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 11 i LPP-se, sepse e ka rekomanduar per kontrate operatorin ekonomik te papërgjegjshëm.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FTD-se dhe te njoftimit per kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe Gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojnë; qe (vi) qe tenderi i zgjedhur te perputhet me te gjitha aspektet përmbajtjesore te kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i Është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues Është dashur ta këtë ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qëllimi i ketij ligji Është te siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera –LE autoriteteve kontraktuese ne Kosove.
Duke u bazuar ne faktet qe u përmenden me larte, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i F'rokurimit qe te shqyrtoj Ankesën tone dhe te nxjerr:

VENDIM

AF'ROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "G3 Inxhiniering SH.P.K & Monten LLC" per Lot 3.
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne rivlerësim, ose te anulohet ne tërësi ky aktivitet i prokurimit për Lot 3, per gabimet e bëra ne dosje te tenderit.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojme procedurën ne institucionet tjera kompetente.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport" LOT 1.

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 7 i LPP - Barazia ne trajtim /jo - diskriminim
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies se kontratës
- Neni 68 i LPP-se - Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta

Pretendimi 1) Ankuesi, pa përgjegjësinë e tij, përjeton keqfunksionim të Portalit PP që çoi në Ankuesin që të mos ishte në gjendje të ngarkonte një pjesë të dokumenteve të tenderit të cilat Autoriteti Kontraktues më vonë deklaroi se nuk ishin siguruar.

Afati i fundit për ngarkimin e tenderit ishte 06/10/2020 10:00

Gjatë ngarkimit të tenderit më 06/10/2020 në 04:00 Paditësi ka përjetuar mosfunksionim të portalit PP ku ne nuk ishim në gjendje të ngarkonim ofertën dhe të gjitha bashkëngjitjet përkatëse. Ne kemi njoftuar agjencinë PP dhe CO dhe kërkesën për zgjatjen e afatit por asnjë përgjigje nuk është dhënë që nga ajo kohë (ju lutemi gjeni ankesat me email në nenin 9 - lista e provave).

Në lidhje me Programin e Çmimeve të Tenderit tonë ne dëshirojmë të theksojmë se çmimi për pozitat të cilat nuk janë përmbushur dhe pozicionet 14.3. të tabelës së parë dhe pozicionit 1.5. në tabelën e dytë të zbritur si 0. përfshihen në çmimin e pozicioneve të tjera të Çmimit

Programi Përveç kësaj, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se çmimi i tenderit të ankuesit përfshin të gjitha pozicionet e listës së çmimeve dhe i referohet lëndës totale të prokurimit.

Pretendimi 2) Provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE ABB Power Grid Zagreb d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale sipas kërkesave të tenderit

Lidhur me dosjen e Tenderit 49-2020, datë 18.09.2020., Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS) dhe Pika 9.1. & 9.2. Kërkesat e aftësive teknike dhe / ose profesionale:

Kërkesa për LOT 1 & 2 - Ofertuesi duhet të provojë se ka zbatuar të paktën tre projekte të nënstacioneve GIS, të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm 110kV ose më të lartë, brenda 3 viteve të fundit, në vendet e BE-së duke përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Një listë që specifikon parimet përkatëse të performancës që specifikon; punime te ngjashme; shumën e kontratës; data dhe marrësi i dëshmuar nga Certifikata Përfundimtare e Pranimit (Çertifikata e Pranimit Final) nga Autoriteti Kontraktues ose 3 referenca të ngjashme për projektin e përfunduar.

Provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga E.O. Rrjetet e Energjisë ABB Zagreb d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale sipas sa më poshtë:

i) SS KRS PADENE nuk ka të bëjë me kërkesë të ngjashme të projektit (implementimi i projektit 110 kV GIS SS) pasi pajisjet primare të dorëzuara HV nuk janë GIS por zgjidhje hibride PASS.

ii) NS MESIHOVINA nuk ka të bëjë me kërkesë të ngjashme të projektit (zbatimi i projektit SS 110 kV GIS SS) pasi pajisjet primare të dorëzuara HV nuk janë GIS.

iii) SS SPLIT 3 nuk ka të bëjë me kërkesa të ngjashme të projektit (zbatimi i projektit 110 kV GIS SS) pasi qëllimi i projektit është dorëzuar vetëm pajisje primare HV por jo implementim (instalimi, testimi, komisionimi, energjizimi etj.).

iv) SS DARDANIA, SS DRENASI, SS ILIRIDA janë të gjitha pjesë e një projekti të vetëm për zbatimin e projektit 110 kV GIS SS dhe nuk përmbushin kërkesën për të provuar zbatimin e suksesshëm dhe përfundimin e suksesshëm të 3 projekteve.
v) SS PRISHTINA 4 nuk ka të bëjë me kërkesë të ngjashme të projektit (zbatimi i projektit 110 kV GIS SS) pasi pajisjet primare të dorëzuara HV nuk janë GIS por zgjidhje hibride PASS dhe kjo nuk është zbatim i vetëm i projektit dhe zgjerimit siç kërkohet.
vi) SS PRISHTINA 4 nuk ka të bëjë me kërkesë të ngjashme të projektit (implementimi i projektit 110 kV GIS SS) pasi pajisjet primare të dorëzuara HV nuk janë GIS por zgjidhje hibride PASS dhe ky nuk është implementimi i projektit të rindërtimit siç kërkohet.

Pretendimi 3) ABB Power Grid nuk plotësojnë kërkesat minimale teknike - fleta e të dhënave pjesërisht jo e plotë (mungon faqja 8 - 20 nga 21).
Dokumentet teknike që vërtetojnë pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat teknike të vendosura nga CO në lidhje me fletën e të dhënave teknike të plotësuara për pajisjet elektrike 35kV MV që u janë dërguar tenderuesve në sqarimet 02_shtoni informacionin nr. 3 - pjesa e dytë-20200924, DT-MP-004, Info 6 Pyetja Nr. 11, faqe 8 deri në faqen 20 nga 21 mungon dhe do të bëjë EO ABB Power Grids Zagreb mos plotësoni kërkesat minimale dhe duhet të eliminohen.
Shkelje e ngjashme, fletë e të dhënave pjesërisht e paplotë, në ofertën e "DOKO" sh.p.k paraqitur për LOT 3 të tenderit subjekt rezultoi në eliminimin e tenderuesit bazuar në letra e marrë B42- Standard për tenderuesin e eliminuar të marrë më 24.11.2020

Pretendimi 4) ABB Power Grids nuk plotësojnë kërkesat minimale teknike - fletë e të dhënave pjesërisht jo të plota (Faqe 1 deri në faqen 4 nga 7).
Dokumentet teknike që vërtetojnë pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat teknike të vendosura nga CO në lidhje me fletën e të dhënave teknike të plotësuara për Transformatorët e Energjisë që u është dërguar tenderuesve në sqarimet 07_ shtoni informacionin Nr. 5-partone, DT-MP-004, Tabela 1:
Të dhënat teknike për Transformatorin e Energjisë 110/35/10 (20) kV, faqe 1 deri në faqen 4 nga 7 mungojnë dhe Rrjetet e Energjisë EO ABB Zagreb d.o.o. nuk plotësojnë kërkesat minimale dhe duhet të eliminohen.
Shkelja e ngjashme, fletë e të dhënave pjesërisht e paplotë, në ofertën e "DOKO" sh.p.k paraqitur për LOT 3 të tenderit subjekt rezultoi në eliminimin e tenderuesit bazuar në B42 - Letra standarde e marrë për tenderuesin e eliminuar të marrë më 24.11.2020.
Pretendimi 5) Provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga ABB Power Grids nuk janë të qarta - EO ABB Power Grids Zagreb d.o.o. nuk deklaroi nëse fusha e tij e furnizimit përfshin artikujt e përmendur më poshtë si të detyrueshëm, siç kërkohet nga kërkesa e tenderit.
Gjegjësisht, në lidhje me dokumentet teknike që vërtetojnë përmbushjen e të gjitha kërkesave të vendosura nga CO në lidhje me tërësinë e fushës së furnizimit me sistemin GIS bazuar në specifikimin teknik 20200817_Specifikimi Teknik SS Kastrioti, Artikuj 4.2 110 kV Pajisjet dhe pajisjet e veçanta të izoluara me gaz 4.2.13 Pajisjet dhe mjetet speciale që përcaktojnë: Pajisjet e mëposhtme do të sigurohen si pjesë e pajisjeve speciale dhe çmimet e tyre do të përfshihen në çmimin e tenderit dhe do t'i dorëzohen punëdhënësit në gjendje të mirë pas përfundimit të testit të komisionimit.
• një grup pajisjesh për matjen e shkarkimit të pjesshëm të zbatueshëm për pajisjet e pajisjeve të ndërprerësit SF6,
• çdo përshtatës, fllanxhë, pajisje shtesë, bulona, etj., Të domosdoshme që lidhin forcën e mësipërme me pajisjet e ndërprerësit
• Njësitë e trajtimit të gazit SF6 për nxjerrjen dhe pompimin e gazit SF6 të kompletuar me kompresorë, depozita magazinimi, matës, tubacione, pompa vakumi, etj.

• Një grup shishesh SF6 të kompresuar, secila e mjaftueshme për një qark ushqyes 110 kV dhe një qark transformatori.
• matës presioni i lëvizshëm për kontrollimin periodik të presionit të gazit SF6 në ndarje të ndryshme,
• Një grup detektorësh gazi SF6, instrument i llojit portabël, i projektuar për zbulimin e gazit SF6 duke dhënë tingull të dëgjueshëm me lartësi të ndryshueshme dhe një tregues vizual të fortë dhe të qartë kur zbulohet gazi.

Pretendimi 6) ABB Power Grids ishte i detyruar të nënshkruaj formularin e dorëzimit të tenderit me nënshkrim elektronik pasi ABB Power Grids posedon një nënshkrim të tillë elektronik.

Sipas rregullave të portalit PP (referimi në dokumentin E - Prokurimi - Operatorët Ekonomikë, E-Tenderimi - Përgatitja dhe paraqitja e dokumentit të Ofertës, shtojca 17 e Krijimit të "Formularit të Dorëzimit të Tenderit" - Nënshkrimi i Formularit të Dorëzimit të Tenderit) ABB Power Grids nuk ka nënshkruar dixhitalisht Formularin Zyrtar të Dorëzimit të Tenderit, ndërsa ofertuesit e tjerë (Koncar KET dhe Enbi Power e kanë bërë këtë sipas rregullave). Manuali i prokurimit elektronik lejon që formulari i dorëzimit të tenderit të mos nënshkruhet me nënshkrim elektronik vetëm nëse përdoruesi nuk ka një nënshkrim të tillë elektronik. ABB Power Grids posedojnë e-nënshkrimi i tillë siç është i detyrueshëm në procedurat e prokurimit publik në Kroaci, ku ABB Power Grids ka vendbanimin dhe rregullorja merr pjesë në tenderët e procedurave publike. Prandaj ABB Power Grids ishte e detyruar të nënshkruaj formularin e dorëzimit të tenderit me nënshkrim elektronik

Pretendimi 7) Provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE ABB Power Grids Zagreb d.o.o. mos plotësoni kërkesat minimale pasi nuk është plotësisht e qartë dhe jo transparente se kush është prodhuesi pasi MAF ka çështjet vijuese:

Lidhur me dosjen e Tenderit 49-2020, datë 18.09.2020., Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS) dhe Pika 9.1. & 9.2. Kërkesat e aftësive teknike dhe / ose profesionale: Kërkesa për LOT 1 & 2 - Autorizimi i Prodhuesit OE duhet që në ofertën e tij të paraqesë kopjen e Autorizimit nga Prodhuesi për pajisjen GIS. Fituesit përkatës do të kërkohet të sjellin origjinal autorizimin MAF i paraqitur është nënshkruar dhe vulosur nga ABB Power Grid Switzerland Ltd me seli në Zvicër, por në fjalinë e parë, prodhuesi është deklaruar të jetë personi tjetër juridik Hitachi ABB Power Grids. Kjo e bën MAF të pavlefshme pasi nuk është e qartë kush është prodhuesi dhe kush nënshkroi dokumentin eliminues.

Pretendimi 8) Provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE ABB Power Grids Zagreb d.o.o. mos plotësoni kërkesat minimale pasi nuk është plotësisht e qartë dhe jo transparente se kush saktësisht është prodhuesi i pajisjes lëndore. Lidhur me dosjen e Tenderit 49-2020, datë 18.09.2020., Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS) dhe Pika 9.1. & 9.2. Kërkesat e aftësive teknike dhe / ose profesionale:

Kërkesa për LOT 1 & 2 - Ofertuesi duhet të provojë që Prodhuesi i pajisjeve ka të paktën 10 vjet përvojë në prodhimin e pajisjeve GIS. Deklaratë e nënshkruar për përmbushjen e kërkesës.
Deklarata e paraqitur është nënshkruar dhe vulosur nga ABB Power Grid Switzerland Ltd me seli në Zvicër, por në fjalinë e parë, prodhuesi është deklaruar të jetë personi tjetër juridik Hitachi ABB Power Grids. Kjo e bën deklaratën të pavlefshme pasi nuk është e qartë kush është prodhuesi dhe kush nënshkroi dokumentin eliminues.
Pretendimi 9) Provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE ABB Power Grids Zagreb d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale pasi nuk është plotësisht e qartë dhe jo transparente kush saktësisht është prodhuesi i pajisjes lëndore.

Lidhur me dosjen e Tenderit 49-2020, datë 18.09.2020., Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS) dhe Pika 9.1. & 9.2. Kërkesat e aftësive teknike dhe / ose profesionale:
Kërkesa për LOT 1 & 2 - Udhëheqësi i Ofertuesit / Konsorciumit duhet të dokumentojë që prodhuesi GIS ka prodhuar dhe dorëzuar të paktën 20 sisteme të pajisjeve GIS në tregun e BE dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor në 3 vitet e fundit.
Deklarata e nënshkruar për përmbushjen e kërkesës duke specifikuar të gjitha Nënstacionet ku janë instaluar sistemet GIS

Deklarata e paraqitur është nënshkruar dhe vulosur nga ABB Power Grid Switzerland Ltd me seli në Zvicër, por në fjalinë e parë, prodhuesi është deklaruar të jetë personi tjetër juridik Hitachi ABB Power Grids. Kjo e bën deklaratën të pavlefshme pasi nuk është e qartë kush është prodhuesi dhe kush nënshkroi dokumentin eliminues.
PADIA 10) Provat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të paraqitura nga E.O. Rrjetet e Energjisë ABB Zagreb d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale, pasi nuk ka asnjë deklaratë të pakushtëzuar nga banka që thotë se E.O. ka një qasje në burimin e financimit ekuivalent me vlerën e projektit, siç kërkohet nga Dokumenti i Tenderit, Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS).

Sipas dosjes së Tenderit 49-2020, datë 18.09.2020., Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS) dhe Pika 8.1. & 8.2. Kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare për LOT 1 & 2 Ofertuesi duhet të dokumentojë që ka qasje në burimet e financimit për vlerën e projektit (= 4,956.000 EUR për LOT1 dhe = 4.250.000 për LOT2). Sipas LPP-së, qëllimi i këtij kriteri është të vlerësojë nëse tenderuesi ka qëndrueshmëri të mjaftueshme financiare dhe ekonomike për të kryer kontratën e propozuar. Operatorët ekonomikë, si rregull i përgjithshëm, do të lejohen të plotësojnë një kërkesë të tillë duke paraqitur, siç mund të jetë e përshtatshme dhe e përshtatshme, një ose më shumë referenca të mëposhtme.

deklaratë ose deklarata të përshtatshme nga një ose më shumë banka që vërtetojnë disponueshmërinë e shumës së kërkuar, siç thuhet në TDS për vlerën e projektit në llogarinë bankare të kompanisë ose një deklaratë bankare (premtim) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi nëse është e nevojshme, për vlerën të projektit.

Në këtë rast ABB ofroi deklaratë nga banka, megjithatë deklarata është e kushtëzuar - në varësi të vlerësimit paraprak të bankës të dokumentacionit specifik të transaksionit dhe pozicionit financiar të Klientit (ABB Power Grids) dhe pranimi i tyre nga banka. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që në rast se tenderimi i jepet ABB Power Grids, banka e tyre mund të mos mbështesë Klientin (ABB) në këtë projekt në rast se vlerësimi paraprak i bankës është negativ.

Për shkak se deklarata është e kushtëzuar është e qartë se ABB Power Grids nuk i përmbushën kërkesat e sipërpërmendura të tenderit për të konfirmuar që të kenë një qasje në burimin e financimit ekuivalent me vlerën e projektit, siç kërkohet nga Dokumenti i Tenderit, Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS).

Propozimi:
Ne i propozojmë Organit Shqyrtues që të shqyrtojë pretendimet tona si të bazuara dhe të aprovojë ankesën tonë dhe të detyrojë autoritetin kontraktues që ta kthejë tenderin në rivlerësim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Te vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

- OE ankues "EL POWER" për LOT 4 pretendon se AK ka bere shkelje te dispozitave te LPP-se pa përmendur se cilat janë ato dispozita te cilat janë shkelur.
- OE "ELECTRA" për LOT 3 pretendon se AK ka rekomanduar për kontratën OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e specifikimit teknik dhe te dosjes se tenderit dhe si i tillë është i pa përgjegjshëm.
- OE "DOKO" për LOT 3 pretendon se eliminuar pa te drejte nga AK me arsyetimet se nuk i ka plotësuar kërkesat e specifikimit teknik te dosjes se tenderit.
- OE "G3-Inxhiniering" per LOT 3 është eliminuar si ofertues i pa përgjegjshëm nga AK me arsyetimin se nuk është vendosur çmimi ne një pozicion ne listën e çmimeve.
- OE "Končar" per LOT 1 është eliminuar nga AK si tenderues i pa përgjegjshëm me arsyetimin se nuk është ofruar një pjese e dokumenteve te kërkuara ne dosjen e tenderit dhe nuk janë vendosur çmimet ne disa pozicione ne listën e çmimeve.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës se OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).
Komisioni i vlerësimit te ofertave, OE ankues "El -POWER" ka vlerësuar si tenderues i pa suksesshëm për LOT4. Ndërsa OE ankues "ELECTRA" komisioni i vlerësimit te ofertave e ka vlerësuar po ashtu si tenderues i pasuksesshëm për LOT 3. Kurse OE ankues "DOKO" komisioni i vlerësimit te ofertave e ka kualifikuar si tenderues i pa përgjegjshëm për LOT 3 për shkak se nuk ke plotësuar një pozicion ne listën e çmimeve. Gjithashtu komisioni vlerësues i AK ka kualifikuar si tenderues i pa përgjegjshëm OE "G3 – Inxhinierin" për LOT 3 për shkak se nuk ka vendosur çmimin ne një pozicion ne listën e çmimeve. Po ashtu edhe OE ankues "Končar" për LOT 1 e ka vlerësuar si tenderues i pa përgjegjshëm për shkak se nuk ka ofruar dokumente e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe nuk ka plotësuar nje pozicion ne listën e çmimeve.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese. Lidhur me raportin e vlerësimit te ofertave dhe letrave standarde për eleminim.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjti është dhënë vlerësim tjetër).
Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "EL-Power & AL-Focus" LOT 4

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Grupi ynë i Operatoreve Ekonomik EL-POWER, AL FOCUS7 sh.p.k jemi njoftuar nga AK se oferta (tenderuesi) i pasuksesshëm për tenderin ne fjale, pa te drejte, ne mënyrë jo objektive dhe jo ligjore për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo te drejte te gjendjes faktike si dhe shkeljes se dispozitave ligjore nga ana e AK Oper.Sistemi,Trans, Dime Trgu KOST SHA, kështu qe duke u bazuar ne këtë, konsiderojmë se vendimi për eliminimin tone është plotësisht i padrejte, jo objektiv dhe i shoqëruar me shkelje, ligjore, ku janë shkelur ne tërësi dispozitat e Ligjit te Prokurimit (LPP-s)Nr.04/L-042 si dhe dispozitat e RRUOPP-secilat i precizojmë si me poshtë. eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Bazuar ne letrën standarde për njoftim te tenderuesit (B46), operatori ekonomik ankues është kualifikuar si tenderues i pa suksesshëm. Pra oferta e OE ankues nga komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues nuk është eliminuar siç thekson OE ankues. Nuk është rekomanduar për kontrate ne LOT 4 për shkak te çmimit me te lartë te ofertës ne raport me operatorin ekonomik fitues. Pra nuk qëndron pretendimi se oferta e OE është eliminuar, oferta ka qene e pasuksesshme.

Ne ankesën e OE ankues e cila është e ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi nuk është theksuar asnjë pretendim tjetër dhe nuk është përmendur asnjë nen apo dispozite e LPP-se e cila është shkelur nga AK. Pra ankesën te cilën e ka shkarkuar eksperti shqyrtues nga sistemi elektronik është e mangët dhe pa asnjë dëshmi apo pretendim për shkelje te LPP-se. Prandaj nuk kemi se çka te shqyrtojmë ne këtë ankese.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Electra" LOT 3

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate për LOT 3 ka dorëzuar ofertën me dy variante të variante të njëjta të zgjidhjes teknike nga dy prodhues të ndryshëm për mbrojtje Rele dhe SCADA nga prodhuesi SIEMENS dhe GENERAL ELECTRIC. Ndërsa sipas FDT-së pika 4.1 variantet nuk kanë qenë të autorizuar, pra në këtë rast është bërë shkelje e nenit 29 të LPP-së (variantet e specifikimeve teknike), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Specifikimi teknik i kësaj lende është mjaft voluminoz me shume material dhe bukur shume kompleks. Bazuar ne specifikimin teknik te dhënë nga AK ne gjuhen angleze qe është version gjuhësor mbisundues ne këtë rast, te pika 4.5.2 Protection Equipment (faqe 123-124) shkruan:

"Main protection system devices must be from the same Manufacturer as the substation control system. Only second main protection and some less important devices (back-up protections and control panels, transformer monitoring units, AVC for OLTC, etc.) <u>might be from a different Manufacturer".</u>

Sipas ketij formulimi në specifikimin teknik te dosjes se tenderit, pajisjet kryesor te sistemit mbrojtës duhet te janë nga i njëjti prodhues, si kontrolli i nënstacionit te sistemit, kurse mbrojtja e dyte kryesore dhe disa pajisje më pakë të rëndësishme (mbrojtja rezervë dhe panelet e kontrollit, njësitë e monitorimit të transformatorëve, AVC për OLTC, etj) munden të janë nga një prodhues tjetër..

Nga kjo rezulton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur variante por ju ka përmbajtur specifikimit teknik të dhënë si më lartë që ka mundësuar prodhues të tjerë për pajisje jo shumë të rëndësishme. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Për pretendimi vijues per piken 2 dhe 3 ankesës së OE ankues, se Autoriteti Kontraktues KOSTT ne përgjigjet klasifikuese te dërguara me date 24.09.2020 nga ora 14:12 deri ne orën 14:52 dokumenti 4. Add information No 3- part two-20200924 . Operatori ekonomik Enbi Power ne dosjen e dorëzuar ne KOSTT dhe pyetjet qe janë bere nga komisioni për vlerësim Operatori Ekonomik Enbi Power është deklaruar se pranon qe mbrojtjet te jene nga prodhuesi Siemens dhe ne gjate kontrolles kemi pare qe Operatori Ekonomik Enbi Power ka deklaruar se për Mbrojtjet Rete "backup" te prodhuesi ABS ose Schneider Electric dhe për këto mbrojtje gjate kontrollës qe i kemi bere kemi ardhur ne përfundim qe mungon deklarata e nënshkruar nga Operatori Ekonomik si dhe Referencë Lista duke specifikuar te gjitha pajisjet ku janë liferuar për Mbrojtje Rele për Prodhuesit ABB. Po ashtu sipas pikës 3 te ankese mungon edhe Autorizimi nga prodhuesi, eksperti shqyrtues ka këtë mendim

Ne ofertën e OE fitues për LOT 3 qe është e ngarkuar ne platformën e prokurimit e-prokurimi janë te bashkangjitur deklarata e nënshkruar nga OE i rekomanduar per kontrate dhe reference lista qe specifikon pajisjet ku janë liferuar.

Kopjen e deklaratës po e japim me poshtë te kopjuar me "Take a snapshot" po ashtu me te njëjtën mënyrë te bashkangjitur ju japim edhe një faqe te listës se referencave si dëshmi. Përndryshe Lista e referencave ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate përmbajnë disa faqe. Gjithashtu ne oferte është i bashkangjitur edhe autorizimi.

Mbi këtë baze vlerësojmë se pretendimi ankimor i OE ankues për këto dy pika është i **pa bazuar**.

EnBi POWER sh.p.k.
Electrification & Construction

Numri i Prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1 – Tërësi Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP

DEKLARATA
MBI PERMBUSHJEN E KERKESAVE TE LIFERIMIT TE PAJISJEVE

DUKE PASUR PARASYSH SE *EnBi Power shpk* me tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes se tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur;

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: EnBi Power shpk konfirmoj se:

Prodhuesi për ndërprerës, mbrojtje Rele, ndarës ka prodhuar dhe liferuar se paku 50 pajisje ne tregun e BE te tensionit 110kv e ma lart ne tri vitet e fundit .

Bashkelidhur kesja deklarate gjeni listen e specifikuar te te gjitha pajisjet ka janë te liferuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	EnBi Power shpk
Adresa e plotë:	Rruga "Kavajes", Qendra 100 Vitrinat, Kulla2, Kati3 Tirane
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Tajar BREGASI
Pozita:	Administrator
Nënshkrimi:	
Data:	05.10.2020
Vula:	REPUBLIKA E SHQIPËRISË ELEKTRIFIKIMI & NDËRTIMI EnBi Power Shpk Imp Eksp

Reference List - Circuit Breakers 245kV type - GL314 (X)
2009 - 2019

Country and End User	Delivery Date											
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Total
Albania					8	1					2	11
DEVOLL HYDROPOWER SHA					8							8
KESH SHA						1						1
OST OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT SHA											2	2
Algeria	1			38		61	12	14				126
COMPAGNIE DE L'ENGINEERING DE L'ELECTRICITE ET DU GAZ SPA								14				14
SOCIETE ALGERIENNE DE GESTION DU RESEAU DE TRANSPORT DE L'ELECTRICITE SPA GRTE-SPA						18	12					30
SOCIETE ALGERIENNE DE GESTION DU RESEAU DE TRANSPORT DU GAZ SPA						13						13
SOCIETE ALGERIENNE DE REVETEMENT SPA				15								15
SOCIETE DE TRAVAUX ET MONTAGE ELECTRIQUES " KAHRAKIB "				9		30						39
SONELGAZ KOLP	1											1
SONELGAZ PRODUCTION D ELECTRICITE				14								14
Angola				8								8
REDE NACIONAL DE TRANSPORTE DE ELECTRICIDADE				8								8
Argentina	10	1										11
COMPANIA DE TRANSPORTE DE ENERGIA ELECTRICA EN ALT		1										1
